

Gazetë javore, letrare & kulturore, e përditshme online

NACIONAL

Drejtor Mujë Bucpapaj
e-mail: bucpapaj@yahoo.com

Mobi 068 20 74 316

www.gazeta-nacional.com

Adresa: Ish-kinstudio "Shqipëria e re", Tiranë
e-mail: nacionalalbania@yahoo.com

Ministria e Arsimit e Kinës, fut teorinë e Marinaj, në programet shkollore

Shoqata e Shkrimtareve të Serbisë promovon në Beograd poezinë e poetit Gjokë Marinaj

Nga Arben Çokaj

faqe 4



Romani i Sulejman Matos "Njerëzit janë si retë"

Pasqyrim i një jete në përpëlitje midis ëndrrës dhe realitetit

Nga Mikel Gojani

faqe 10



EDITORIAL

Mesazhet universale të një Odiseu poetik

Nga Xhelal ZEJNELI

Vëllimi me poezi Troja e kalit, i poetit të mirënjohur Shaip Emërllahut, përmban 52 poezi. Përmbledhja përfundon me një poezi që ia dedikon atij, poeti francez Athanas De Thraki. Ky vëllim hapet me një vështrim të thuktë të poetit amerikan Xhorxh Vallas. Autori ka përmbledhur në libër krijime poetike të shkruara në periudha të ndryshme, duke filluar nga viti 1987 e këndej.



Faqe 4

Mitingu poetik i Gjakovës në 54 vite

Nga LULZIM LOGU

Ka të paktën 10 vjet që ndjehet emocionet e Mitingut të Poezisë, që tash 54 vjet mbahet në Gjakovë, një traditë dhe kontribut mbresëlënës historik, sesi krijuesit në epoka të ndryshme kanë ndërtuar një institucion të vertetë, në kohë lufte dhe në paqe, duke shkëmbyer frymë dhe përvoja jo vetëm letrare. Padyshim se duhet të jetë një ndër organizimet më të veçanta në botën letrare shqiptare, inicuar dhe para-



Faqe 9

A janë varrezat e ushtarëve grekë provokim për një luftë të ardhshme shqiptaro-greke

Ushtarët grekë duhet të përcillen në atdheun e tyre

Nga Mujë Bucpapaj

faqe 21

FLET PËR "NACIONAL" SHKRIMTARJA E TEMAVE SOCIALE



ANITA TAFI: JAM E GEZUAR QË DO TË BOTOJ LIBRIN TIM ME TREGIME NË TIRANË

TE ARBËRESHËT E ITALISË, SHTATOR, 2018

NGA PROF. DR. RAMAZAN H. BOGDANI ("MJESHTËR I MADH")

Sfidat e shoqërisë dhe problemet e perceptimit individual...

NGA GËZIM TUSHI, MJESHTËR I MADH FRAN GJOKA, GAZETAR

NËBRENDËSI

FAQE 5
Poezi nga Kristen D. Scott
Përkthet: Laureta Petoshati

FAQE 17
Nga ëndrra në ëndërr!
Tregim nga Bajram Sefaj

FAQE 11
TRAK-TRAK
Poezi nga DRITA LUSHI

FAQE 18
Vjeshta në hullinë e kujtimeve
Nga Nexhat REXHA

FAQE 6
Fjaleve të shpirtit nuk u vë dot tituj...
Poezi nga Greta Kadare

FAQE 20
Portret i poetit, dhe shkrimtarit Bardhyl Agasi
Nga Bashkim Kadriu

RADIO NACIONAL
93.6MHz
www.radionacional.al

AUTOSHKOLLA LAZE
Autoshkollë "Lazë"
Rr. "Muhamet Qazimi"
përfaqësohet nga Ministria
Cel: 069 20 52 583

AUTOGRILL EMANUEL GASPETROL
Pikë karburanti, Lozhë, Albania

Lajthiza
Premium Water

Marinaj është poet i lirisë, poezitë e tij shërbejnë si një urë që lidh njerëzit pa marrë parasysh kufijtë politikë dhe gjeografikë

Shoqata e Shkrimtareve të Serbisë promovon në Beograd poezinë e poetit Gjekë Marinaj

Nina Simic: "Gjekë Marinaj krijon një bukuri të pastër kozmike të mishëruar brenda një qenie të jashtëzakonshme"

Arben Çokaj

Këto ditë poeti shqiptaro-amerikan Dr. Gjekë Marinaj ishte i ftuari i Shoqatës së Shkrimtareve të Serbisë për dy evenimente letrare dhe kulturore. Njëri ka të bëjë me ftesën e tij për të marrë pjesë në promovimin e librit me poezi të zgjedhura të Marinajt "Vij për të risuar", përkthyer në serbisht nga përkthyesi Pjetër Dreshaj. Ndërsa evenimenti tjetër i përket një ftese nga e njëjta shoqatë, por këtë herë në një cilësi tjetër, pra si shkrimtar përfaqësues i Amerikës në Asamblenë e 55-të të Shkrimtarëve Ndërkombëtarë në Beograd.

Promovimin e librit, i cili u bë në sallën kryesore të Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë në Beograd, e hapi poeti proleptik serb Miljurko Vukadinoviç i cili ndër të tjera tha se "Marinaj është shqiptar nga lindja dhe Amerikan nga profesioni. Letërsia e arrirë e tij edhe në gjuhën tonë, ashtu si dhe ai vetë, janë pjesë e kulturës dhe gjithmonë në mirëpritje të plotë nga të gjithë ne."

Më pas fjalën e mori Doc. Prof. Jovan Janjic, i cili theksoi se "Marinaj është poet i lirisë, poezitë e tij shërbejnë si një urë që lidh njerëzit pa marrë parasysh kufijtë politikë dhe gjeografikë. Audiencia e tij është krejt njerëzimi".

Ndërsa zonja shumë e talentuar, Nina Simic, përkthyes dhe zëdhënëse e Shoqatës së Shkrimtareve të Serbisë, e përkufizoi me këto fjalë poezinë e Marinaj: "Gjekë Marinaj krijon një bukuri të pastër kozmike të mishëruar brenda një qenie të jashtëzakonshme - njësoj për të gjithë njerëzit dhe pothuajse përtej njerëzimit, por me një stil të dukshëm të përmasave kozmike. Poezitë e tij janë po aq opalescent sa që reflektojnë në të njëjtën kohë të gjitha cilësitë e fisnikëruara dhe sublime, duke rritur frymën e auditorit të tij letrar, në mënyrë që ata të mund të arrijnë dhe të



kuptojnë potencialin e plotë të leximit pozitiv në një unitet të mrekullueshëm - perfekt nga natyra përmes përsosmërisë krejtësisht natyrore - pa asnjë gjurmë pretencioze në vargjet e tij"

Poezitë e Marinajt u promovuan edhe në dy qytete të tjera të Serbisë, pikërisht në Aleksandrovac dhe Vrnjačka Banja. Marinaj u prezantua dhe lexoi poezitë e tij, botuar edhe në një antologji të veçantë me poetët ndërkombëtarë, pjesëmarrës në Asamblenë e 55-të të Shkrimtarëve Ndërkombëtarë në Beograd, në disa biblioteka, muze dhe institucione të tjera të Beogradit, Aleksandrovacit dhe Vrnjačka Banjes. Gjatë vizitës së tij 5 ditore, Marinaj dhe disa nga shkrimtarët e tjerë shoqëruar u moderua dhe prezantua para mediave dhe publikut serb nga gazetari i njohur televiziv i Serbisë Misa Ciriç, i cili vuri gjithë talentin dhe dedikimin e tij, për

të vënë në pah vlerat letrare dhe kulturore të eventit.

Jugoslav Stajkovic, Kryetari i bashkisë së Qytetit Aleksandrovac, shtroi një darkë të veçantë me këtë rast, ku ishin të ftuar shumë njerëz të letrave nga qyteti i tij, si dhe shumë shkrimtarë e poetë nga vendet e ndryshme të Evropës si Italia, Ukrahina, Bosnja, Rumania etj. Ai tha ndër të tjera për të pranishmit se "është kënaqësi për bibliotekat publike dhe universitare të Serbisë që ta kemi të gatshëm për lexuesin tonë librin e Marinajt në gjuhën Serbe". Me të njëjtin optimizëm u shpreh edhe poetja nga serbe Neda Gavrić: "Poezitë e Gjekë Marinajt frymëzojnë të gjithë ata, që kërkojnë angazhim shpirtëror dhe përsosje të jetës me vlera të vërteta kulturore, artistike dhe estetike. Pothuajse çdo gjë që është e bukur në këtë botë dhe që buron ndjenjën e ekzistencës mund të

shijohet në mënyrë poetike përmes poezive të Marinajt. Lexuesit e këtyre Poezive padyshim do të ndjehen më të pasur shpirtërisht, sepse Marinaj u jep atyre ide të qarta se pasuria shpirtërore është shumë më e rëndësishme se ajo materiale. Këto poezi me siguri do të marrin frymë në gjoks dhe secilit njeri, që ka një ndjenjë të mirë për letërsinë."

Përshtypje të mirë për të pranishmit la dhe mendimi i poetes, përkthyeses dhe gazetares ruse Elena Buevich: "Sidomos për ata që përdorin alfabetin cirilik, përkthimi në gjuhën serbe i poezive të Gjekë Marinajt është një mundësi e madhe për t'u njohur me botën e madhe të këtij poeti. Kam ngulur e kënaqur me imazhet e tij të komplikuar dhe të pasura, gjuhën e tij poetike, e cila në aspektin e dendësisë është si ornament oriental. Edhe pse imazhet e tij alternojnë mjaft dendur, këtu mbizotëron mendimi dhe, më e rëndësishmja, morali. Në këtë libër u njoha me përparësinë morale të heroit lirik të këtyre vargjeve, për të cilin është më mirë të jesh "shërbëtor në parajsë sesa sundues në ferr."

Një nga momentet më të bukura për Marinaj ka qenë takimi surprize me grupin e tij favorit muzikor "Neverne Babe", me të cilët u takua, bëri fotografi miqësore me ta, para se të jepnin një koncert madhështor për të pranishmit në qytetin e bukur Aleksandrovac.

Marinaj, të cilit iu dha disa herë fjala gjatë atyre 5 ditëve, theksoi mirënjohjen e tij të thellë ndaj përkthyesit të tij Pjetër Dreshaj, pjesëmarrësve, kolegëve dhe miqve të tij serbë. Ai falënderoi Ministrinë e Kulturës dhe veçanërisht Shoqatën e Shkrimtarëve të Serbisë, për nderin e madh që i bënë.

Marinaj, i cili pas ikjes nga regjimi komunist shqiptar në shtator të vitit 1992 jetoi në Serbi për rreth 8 muaj, nuk harroi të falënderonte dhe një herë popullin serb për ndihmën dhe pritjen e jashtëzakonshme, që i kanë bërë në ato momente të hershme, shumë të vështira të jetës së tij.

Ministria e Arsimit e Kinës, fut Teorinë e Protonizmit të Dr. Gjekë Marinaj, në programet në shkollë (akademike)



Falenderim i studiuesit Marinaj

Dëshiroj të falënderoj Ministrinë e Arsimit të Republikës Popullore të Kinës, profesorët dhe administratën e Kolegjit Guang Dong Pie Zheng për lajmin e mirë që më sollën për futjen e Teorisë së Protonizmit në programet e tyre shkollë (akademike).

Faleminderit Pham Van Tu për krijimin e logos së Protonizmit për ta

I would like to thank the Ministry of Education of the People's Republic of China, the faculty and administration of Guang Dong Pie Zheng College for making (my) Protonism Theory part of their graduate academic program. Thank you Pham Van Tu for designing the Protonism logo for them.

